

Data: 12/08/21 Ref.: 30/2/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universiteti të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, BSc ,180 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik;
 - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
 - Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
 - Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
 - Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, BSc, 180 ECTS, me specializim: 1. Elektronikë; 2. Automatikë dhe Robotikë, maksimumi 120 studentë për vit akademik.
 - Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Nuk akreditohet programi i studimit:
- Elektroenergjetikë, BSc ,180 ECTS
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike që deri më 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programieve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, BSc ,180 ECTS	Enver Hamiti Hena Maloku Valdete Rexhebeqaj
2	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, MSc, 120 ECTS	Mimoza Ibrani Bujar Krasniqi
3	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, BSc, 180 ECTS	Avni Rexhepi Valon Raça Qefsere Doko Gjonbalaj
4	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, MSc, 120 ECTS	Kadri Sylejmani Isak Shabani
5	Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, BSc, 180 ECTS, me specializim: 1. Elektronikë; 2. Automatikë dhe Robotikë,	Vjosa Shatri Drilon Bunjaku Vezir Rexhepi Marjan Dema
6	Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, MSc, 120 ECTS	Lavdim Kurtaj Milaim Zabeli
7	Elektroenergjetikë, BSc ,180 ECTS	Bahri Prebreza Arben Gjokaj Shqipe Lohaj

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 18.03.2021, 15.04.2021 dhe 06.05.2021, me ekspertët dhe studentë ekspert ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peeter Normak, Josep Balen, Laura Palac dhe Drzen Vrhovski.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, BSc ,180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.

2. Për programin e studimit Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, MSc ,120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një kapitull (1) substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.

3. Për programin e studimit Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht shtatë (7) kapituj.
4. Për programin e studimit Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, MSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht gjashtë (6) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht një (1) kapitull.
5. Për programin e studimit Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, BSc, 180 ECTS, me specializim: 1. Elektronikë; 2. Automatikë dhe Robotikë - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht tre (3) kapituj.
6. Për programin e studimit Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.
7. Për programin e studimit Elektroenergjetikë, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht dy (2) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht pesë (5) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasniye Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.